



DOKUMENTI I

AXHENDËS SË GJELBËR



Prezë, 2007-2009

Realizuar nga:

Grupet e punës për Axhendën e Gjelbër – Komuna Prezë

Nën koordinimin dhe asistencën e Shoqatës Shqiptare të Permakulturës

Me asistencën teknike nga EDEN – Center

Dhe mbështetur financiarisht nga Milieukontakt International

Përmbajtja:

✚ Parathënie	4
✚ Vizioni & Misioni	4
✚ Dokumentat që u konsultuan	5
✚ Analizë e përgjithshme mbi situatën vendore	7
✚ 5 Fazat e procesit të Axhendës së Gjelbër	8
✚ 14 Hapat e procesit të Axhendës së Gjelbër	9
✚ Vlerat kryesore të komunës (për të 3 grupet)	10
✚ Grupi i Infrastrukturës Turistike	19
○ Përcaktimi i tendencave, ndikimeve dhe standardeve	19
○ Problemet dhe shkaqet	21
○ Zgjidhjet e propozuara	22
○ Potencialet, mundësitë dhe prioritizimi i zgjidhjeve	23
○ Plani i veprimit për zbatimin e zgjidhjeve	25
✚ Grupi i Vlerave Etno-kulturore	29
○ Përcaktimi i tendencave, ndikimeve dhe standardeve	29
○ Problemet dhe shkaqet.....	30
○ Zgjidhjet e propozuara.....	31
○ Potencialet, mundësitë dhe prioritizimi i zgjidhjeve	33
○ Plani i veprimit për zbatimin e zgjidhjeve	34
✚ Grupi i pyjeve dhe biodiversitetit	35
○ Përcaktimi i tendencave, ndikimeve dhe standardeve	35
○ Problemet dhe shkaqet.....	41
○ Zgjidhjet e propozuara	42
○ Potencialet, mundësitë dhe prioritizimi i zgjidhjeve	43
○ Plani i veprimit për zbatimin e zgjidhjeve	44
✚ Shtojcat	48

Parathënie

Akhenda e gjelbër është një proces planifikimi gjithëpërfshirës i komunitetit në fushën e mjedisit dhe trashëgimisë kulturore. Ai është prezantuar për herë të parë nga Milieukontakt International në Rumani, Moldavi dhe Kroaci.

Duke shpresuar për një proces të ngjashëm gjithëpërfshirës të bazuar në vlerat e komunitetit dhe në të cilin autorët e drejtimit të zhvillimit të zonës të jenë vetë anëtarët e komunitetit, ky proces u propozua dhe në Shqipëri në 2007.

Vizioni dhe dëshira për të punuar e komunës Prezë si dhe ekzistenca e një komuniteti të kulturuar dhe me dëshirë për të pasur një zhvillim të qëndrueshëm në komunën e tyre, dhe gatishmëria e Shoqatës Shqiptare të Permakulturës për të lehtësuar procesin e Axhendës së Gjelbër në Komunën Prezë, bënë që Preza të ishte një nga tre komunat e përzgjedhura për të realizuar këtë proces.

Me këtë proces synohet nxitja dhe përmirësimi i komunikimit dhe bashkëpunimit mes qeverisë vendore, sektorit të sipërmarrjes, banorëve të zonës dhe organizatave jofitimprurëse, me qëllim që të bëhen plane zhvillimi të qëndrueshme për bashkësitë vendore, bazuar në marrëveshje të përbashkëta.

Si rezultat i këtij procesi të gjatë në komunë është përforcuar fryma komunitare, mjedisi dhe trashëgimia kulturore kanë marrë një dimension tjetër si dhe është arritur në draftimin e një dokumenti për zhvillimin e qëndrueshëm përmes një procesi transparent dhe gjithëpërfshirës. Pas takimit të parë të palëve të interesuara në 22 dhjetor të vitit 2007 u ngritën tre grupe pune, respektivisht **Grupi i infrastrukturës turistike, Grupi i vlerave etno - kulturore e artizanale si dhe Grupi pyjeve dhe biodiversitetit**. Këto grupe përgjatë gjithë vitit 2008 kanë kaluar përmes të gjitha hapave të axhendës së gjelbër si dhe kanë pasur mundësinë të ngrenë kapacitetet e tyre për një sërë çështjesh që janë parë me rëndësi nga vetë grupet si trainime mbi komunikimin me publikun, ngritjen e skuadrave, planifikimin strategjik, shkrimin e projekt propozimeve, ngritjen e fondeve etj.

Dokumenti që po ju paraqitet është fryti i një pune të devotshme 1 vjecare të gjithë anetareve të tri grupeve:

Pyjet dhe Biodiversiteti me koordinator Armand Kurti,
Infrastruktura Turistike me koordinator Z. Saimir Alushi koordinator i grupit [prill – nëntor 2009] & Aldo Sheshaj [dhjetor 09 – mars 2010].
dhe grupi i Vlerave Etnografike dhe Trashegimia Kulturore me koordinator Znj-Suzana Halili.

Vizioni i përbashkët:

“Me anë të rigjenerimit të natyrës dhe ripërtëritjes së vlerave tona etnografike, artizanale e kulturore, të tërheqim më shumë turistë në zonën tonë.”

Misioni i përbashkët:

Me anë të pjesëmarrjes publike, të ndikojmë në vendimmarrjen e përgjithshme të autoriteteve lokale për të jetuar në harmoni me natyrën tonë dhe duke ruajtur vlerat tona kulturore.

Pas analizës dhe pozicionimit të grupeve të interesit u përcaktua **qëllimi i axhendës së gjelbër** si më poshtë:

Të nxitet bashkëpunimi mes komunitetit e qeverisjes lokale, biznesit e qytetarëve për të hartuar e zbatuar së bashku plane zhvillimi të qëndrueshëm për komunitetin tonë.

Dokumentat që u konsultuan

Për të realizuar një studim sa më efikas, grupi i punës iu drejtua arshivës së komunës për të nxjerrë të gjitha projektet e mëparshme, vendimet e Këshillit të Komunës (KK) dhe iniciativa të tjera si Gazeta Preza. Gjithashtu u konsultuam me dokumenta strategjike kombëtare si:

- Strategjia e zhvillimit të turizmit në Shqipëri deri në vitin 2012
- Strategjia e Rritjes ekonomike dhe uljes së varferisë
- Plani i Integruar i Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave
- Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit – Shqipëria
- Strategjia e Plani i Veprimit për Biodiversitetin
- Plani Kombëtar i Veprimit në Mjedis – 2001
- Strategjia e Sigurisë – Ministria e Punëve të Jashtme
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim e Integrim – draft
- Strategjia Kombëtare për Femijet
- Strategjia Kombëtare e Mjedisit - 2006
- Strategjia për Zhvillimin e Pyjeve e Kullotave në Shqipëri

Në tërësi nuk spikatëm ndonjë dokument të rëndësishëm, projekt apo projekt ide të hartuar qoftë nga administrata e mëparshme, apo edhe vendime të KK.

- Nuk ka pasur plane të miratuara zhvillimi mjedisor apo kulturor në Komunën Prezë për periudhën në shqyrtim

Ajo që gjetëm pas hulumtimit të Arkivës së Komunës ishin:

- Vendime komune nga 2001-2007 për
 - Dhënie fondesh për
 - riparim e ndërtim ujësjellësi;
 - riparim shkollash e kopshtesh + sistemim i fushave sportive në shkollat e disa fshatrave;
 - për ndërtim kanalizimesh të ujërave të zeza;
 - asflatim e riparim rrugësh në fshatra;
 - përmirësime të kushteve higjienike të tregtimit të produkteve blegtorale;
 - për vendosjen e transformatorëve të energjisë;

I vetmi dokument me natyrë zhvillimin mjedisor e turistik ishte "Plani i Zhvillimit të Turizmit për Prezën" me autorë "Goulds Properties UK Limited në bashkëpunim me Interest Consultants Limited" sponsorizuar nga "Tirana International Airport". Ky dokument nuk është miratuar nga këshilli i Komunës për vetë koston shumë të lartë të sugjeruar për zbatimin e tij. Gjithashtu duhet theksuar se ky plan zhvillimi është fryt i konsulencës së huaj, pa marrë në konsideratë mundësitë financiare të komunës apo mendimin dhe dëshirat për zhvillim të banorëve të zonës.

Ndërkohë që për Prezën flitet në dokumenta të tilla si:

- 1) Marin Barleti: Historia e Skënderbeut,
- 2) 10 vjet Mbretni 1928-1938,
- 3) Shtjefën Gjeçovi: Mnera e Prezës,
- 4) Johann George Von Hahn: Udhëtim nëpër viset e Drinit dhe të Vardarit,
- 5) Gjergj Karaiskaj: 5 mijë vjet fortifikime në Shqipëri,
- 6) Lazar Papajani: "Kalaja e Prezës", revista Monumentet, 1974, nr.7-8,
- 7) Teki Seleniça: Shqipnia më 1923,
- 8) Teki Seleniça: Shqipnia më 1927,
- 9) Prof. Zyhdi Dervishi .

Ndryshe Preza njihet si qyteti i feniksit për shkak se është shkatërruar dhe rindërtuar disa herë nga luftërat. Feniksi është një zog që lind nga hiri i tij, po kështu edhe Preza. Shkrimtarë të ndryshëm që kanë botuar shkrime interesante në Gazetën lokale “Preza” të botuar gjatë viteve 2004 – 2006 e kanë cilësuar Prezën edhe si Parisi i vogël.

Preza është cilësuar si Parisi i vogël sepse për kohën që ishte, Preza i kishte të gjitha shërbimet bazë si Mjekun, shkollën, xhandarmërinë, pazarin dhe të tjera shërbime bazë që në atë kohë edhe shumë qytete nuk i kishin.

Të gjithë elementet e këtij dokumenti të Axhendës së Gjelbër janë risi dhe fryt i punës së grupeve të punës për Axhendën e Gjelbër.

Materiali u hartua nga grupet e punës që u mbledhën rregullisht dhe u diskutua gjerësisht mes anëtarëve të grupeve të ndryshme. U zhvilluan programe e spote televizive për ta informuar publikun mbi procesin e Axhendës së Gjelbër. U vendosën 3 kënde njoftimesh në vende të dukshme ku me anë të posterave u njoftua çdo hap i procesit dhe u ftua komuniteti për të kontribuar. U shpërndanë 1000 fletëpalosje e 1000 pyetësorë te nxënësit e shkollave të komunës me qëllim arritjen e familjarëve të tyre dhe vjeljen e opinioneve të tyre. Nga dhjetëra pyetësorët e plotësuar idetë u përfaqësuan në këtë material. Grupet e punës qenë në dinamikë të vazhdueshme dhe kjo ishte sukses i procesit. Gjithashtu, më 22 dhjetor 2008 dhe në 12 mars 2009 u mbajtën dy takime të konsultimit të Dokumentit të Axhendës së Gjelbër me publikun ku pjesëmarrësit që vinin nga bizneset dhe intelektualë apo nëpunës të zonës dhanë idetë e tyre për ta pasuruar si dokument.

Analizë e përgjithshme mbi situatën vendore

Popullsia e komunës është afërsisht 6 700 banorë, autoktone me prejardhje qysh në lashtësi nga të njëjtat vendbanime të Fisit Ilir të Parthinëve. Dallohet për fisnikërinë, urtësinë e bujarinë. Dashamirëse e arsimit dhe kulturës, moralit, vlerave dhe punës.

Sipërfaqja e komunës është 242 km² prej së cilës 45 % reliev fushor dhe 55 % reliev kodrinor. 69.5 % e sipërfaqes është tokë bujqësore e cila në pjesën më të madhe punohet, 19.5 % e saj janë pyje dhe ullishta të cilat nuk janë dëmtuar gjatë periudhës së vështirë të 1997-s dhe 11 % janë tokë e pafrytshme.

Distanca nga kryeqyteti i Shqipërisë është 22 km, nga qyteti bregdetar dhe turistik i Durrësit 30 km, nga qyteti historik i Krujës 18 km dhe nga Aeroporti i Rinasit vetëm 6 km. Gjendet gjithashtu në afërsi të rrugëve kryesore për në Tiranë, Durrës dhe Shkodër, duke e bërë atë shumë të arritshëm për një pjesë të madhe të tregut të brendshëm dhe të vizitorëve nga jashtë të cilët dëshirojnë të kalojnë një fundjavë në ajër të pastër.

Megjithëse ka një pjerrësi të madhe mbi fushën e lumit Ishëm dhe pamje nga aeroporti Nënë Tereza, Preza ka relativisht një lartësi të vogël në krahasim me pjesën më të madhe të territorit të Shqipërisë. Pika më e lartë e fshatit është afërsisht 300 metra mbi nivelin e detit.

Komuna e Prezës përbëhet nga 7 fshatra: Prezë Kala, Ahmetaq, Bregshkozë, Ndërmjetës, Palaq, Fushë-Prezë, Gjeç fushë, dhe Gjeç kodër. Në kohën e mëparshme Preza shtrihej deri në Bubqin e sotëm, dhe përbëhej nga 4 fshatra Gjec-Koder, Ahmetaq, Budull dhe Palaq. Asnjëri nga fshatrat nuk kishte emrin Prezë sepse me këtë emër njiheshin të gjithë zona që shtrihej deri në Bubqin e sotëm.

Fshati i Prezës është një bashkësi e vogël prej rreth 2.400 hektarësh. Ky është territori që meriton vëmendjen më të madhe përse i përket përcaktimit të zonës turistike dhe rreth 600 banorë jetojnë atje. Ata i nxjerrin të ardhurat kryesisht nga puna në ndërtim dhe nga bujqësia.

10 vitet e fundit në komunën e Prezës natyra dhe mjedisi ku jetojnë kafshët dhe bimësia ka pasur ndryshime. Këto ndryshime janë të pranishme si rezultat i veprimtarisë së njeriut që ka ndikuar si një faktor negativ për mjedisin.

Mjedisi natyror është burimi të cilin banorët e Prezës duan ta kenë si një nga resurset dhe pikat më të forta të zhvillimit kulturor, social dhe ekonomik të zonës. Ruajtja dhe mbrojtja e këtij mjedisi në kushtet e zhvillimit të vullshëm industrial kërkon hapësirë dhe mjete financiare. Në të njëjtën kohë për t'u vlerësuar është dhe ndërgjegjësimi i komunitetit i cili përbën një element të rëndësishëm në realizimin e kësaj iniciative të Axhendës së Gjelbër.

5 FAZAT E PROCESIT TË AXHENDËS SË GJELBËR

- ❑ Faza 1 – Nisja, Përgatitja dhe Organizimi i Procesit të AGj.

- ❑ Faza 2 – Përgatitja e punës në komunitet (grupe pune). Mbledhje e njohurive ekzistuese; Identifikimi i çështjeve kyçe dhe hendeqeve

- ❑ Faza 3 – Analizë e hollësishme e çështjeve kyçe (Probleme, zgjidhje, alternativa etj), per sektor, grup shoqëror ose zonë

- ❑ Faza 4 – Sintezë dhe Planifikim. Përcaktim i vizionit dhe orientimeve strategjike.

- ❑ Faza 5 – Monitorimi dhe Përmbyllja.

14 HAPAT E PROCESIT TË AXHENDËS SË GJELBËR

- Hapi 1 – Identifikimi dhe analiza e grupeve të interesit dhe dokumentave
- Hapi 2 – Takimi i parë me grupet e interesit
- Hapi 3 – Identifikimi i Vlerave / funksioneve mjedisore
- Hapi 4 – Tendencat e këtyre vlerave / funksioneve mjedisore
- Hapi 5 – Ndikimi i Prirjeve mjedisore
- Hapi 6 – Krijimi i vizionit dhe caktimi i standardeve minimale
- Hapi 7 – Përcaktimi i problemeve kryesore mjedisore
- Hapi 8 – Analiza e kostove të problemeve
- Hapi 9 – Përkufizimi i potencialeve dhe mundësive
- Hapi 10 – Përcaktimi i potencialeve prioritare dhe Zgjidhjeve
- Hapi 11 – Përcaktimi i Planit Strategjik brenda dokumentit të AGJ.
- Hapi 12 – Përcaktimi i Planit të monitorimit
- Hapi 13 – Shkrimi i Dokumentit të AGj
- Hapi 14 – Projektet Pilot

VLERAT KRYESORE TË KOMUNËS

1- Vlerat kryesore të komunës (Grupi i Infrastruktues Turistike)

Vlerat e komunës Prezë janë të shumta. Të cituara nga vetë anëtarët e grupit disa prej tyre janë pyjet, liqenet, ullishtat, kalaja, pusi, pazari, shkolla, folklori, veprat artizanale, mullinjtë e vajit, vreshtaria, burimet ujore, objektet e kultit, produktet organike dhe infrastruktura.

Parë në kontekstin turistik nga grupi u vlerësua historiku shekullor i zonës, traditat, pozicioni i rëndësishëm gjeografik si dhe distanca e përshtatshme nga Aeroporti Ndërkombëtar i Rinasit dhe kryeqyteti i Shqipërisë. Të gjitha këto vlera me pak punë dhe kreativitet nga të gjitha palët e interesuara mund të kthehen në burime zhvillimi dhe të japin rezultate në jetën social-ekonomike të komunitetit.

E për të mos e lënë vetëm në nivelin e dëshirave, grupi i infrastrukturës turistike me anë të këtij dokumenti ju paraqet drejtimet kryesore të punës në këtë sektor si dhe aktivitete konkrete që do të ndërmerren nga pushteti vendor së bashku me komunitetin.

- Kështjella:

Kalaja e Prezës është një ndër tri monumentet historike që rrethojnë qytetin e Tiranës. Ajo është simboli i fshatit dhe ka të ngjarë të ketë origjinë romake dhe e rindërtuar nga turqit në shekullin e 15-të. Kalaja ka formën e një pesëkëndëshi të çrregullt me kulla të rrumbullakta në katër qoshe dhe me një kullë drejtkëndëshe rreth mesit të murit që shtrihet në drejtimin perëndim-lindje.

Kalaja ka gjatësi 80m dhe gjerësi 50m, si dhe trashësi të mureve 1.3 m – 1.4 m. Kjo kala nuk ka qenë përlogaritur për të përballuar rrethime të gjata e bombardime me artilerinë e rëndë. Nga të dhënat e banorëve në kalanë e Prezës është bërë dasma e Mamicës [Motrës së Gjergj Kastriotit] me Muza Topinë, ku u ftuan aristokratë nga vende të ndryshme të botës. Kalaja të ofron pamje panoramike nga të gjitha anët ku vrojtohet qyteti i Tiranës, aeroporti i Rinasit, deti Adriatik në Durrës dhe Kruja. Në ditët e sotme kalaja ka një kafene të vogël në një qoshe në veri-perëndim, një xhami në hyrjen perëndimore, kullën e sahatit në lindje, dy kulla të tjera në perëndim dhe mure të larta rrethues. Terreni i brendshëm i sheshtë është mundësi e mirë për aktivitete kulturore. (Panaire, Miss Shqipëria 2008) duhet përmendur që në kala u inskenua nga një grup arbëresh disa vjet më parë edhe dasma e Mamicës

- Sheshi i pazarit

Vite më përpara zhvillohej një ditë në javë pazari për Prezën dhe të gjithë fshatrat përreth ku banorët tregtonin prodhimet e tyre bujqësore, punimet e tyre artizanale, vajin e ullirit, mjaltin, bagëtitë. Edhe sot e kësaj dite banorët e Prezës sheshin përpara kalasë e quajnë “pazar”.

Përcaktimi i vlerave

Potencialet turistike që ofron kjo zonë janë mundësi të shkëlqyer për lloje të turizmit si:

- Eko-Turizmi
- Turizmi Familjar
- Turizmi Kulturor
- Turizmi Aventuror, etj

Momentalisht Preza nuk është zonë ligjërish turistike, por është një ndër prioritetet e kësaj qeverisje vendore në strategjitë e saj afat-mesme dhe afat-gjata.

Elementët e identifikuar si vlera brenda grupit të Infrastruktues Turistike:

- Zyrë Informacioni
- Muze
- Agjensi Turistike
- Guidë Turistike
- Tabela Informuese
- Akomodimi
- Argëtimi
- Siguria & Shëndeti
- Aksesibiliteti (rrugë, telefon, internet)
- Autenticiteti
- Uji i pijshëm
- Ajri dhe gjelbërimi
- Kanalizimet dhe
- Menaxhimi i mbetjeve urbane

2-Vlerat kryesore të komunës (Grupi i vlerave Etnografike)

Vlerat e komunës Prezë në sferën e etnografisë janë të shumta. Të cituara nga vetë anëtarët e grupit disa prej tyre janë Kalaja, kultet fetare, vlerat etnografike, punimet artizanale dhe trashëgimia kulturore. Gjatë fazës së dytë të procesit grupi pati mundësinë të bënte një evidentim të hollësishëm të vlerave si funksione, mundësi ekonomike & kulturore.

Duke e analizuar të gjithë historikun dhe materialet / dokumentat të cilat flasin për Prezën grupi arriti në konkluzionin se vlerat brenda grupit të mësipërm janë si më poshtë vijon:

- Kalaja,
- Pazari,
- Kultet fetare, xhamia,
- Pusi,
- Folklori,
- Kostumet: a) tradicionale, b) popullore
- Punimet artizanale,
- Mullinj të e vajit,
- Ullishta.

Për secilën nga vlerat është dhënë një panoramë e shkurtër pasi ato janë të rëndësishme për historinë dhe zhvillimin e Prezës:

Një historik i shkurtër për Prezën:

Preza ka qenë Qyteza e Parthinëve, e quajtur ndryshe qyteti Feniks apo Parisi i vogël (marrë nga materialet e profesor Zyhdi Dervishi). Nga studiues të ndryshëm që në atë kohë kanë shkruar për Shqipërinë dhe për Prezën. Si:

- Barleti, Marin: Histori e Skënderbeut, Shtëpia Botuese "Faik Konica", Prishtinë 2001.
- 10 vjet Mbretni 1928-1938, Tiranë 1938
- Gjeçovi Shtjefn: Mnera e Prezës, Botim i Shoqatës Kulturore "Pellazgët", Tiranë 2000.
- Hahn, Johann George Von: Udhëtim nëpër viset e Drinit e të Vardarit, Shtëpia Botuese "Geer", Tiranë 2001.
- Karaiskaj Gjergj: 5000 vjet fortifikime në Shqipëri, Shtëpia Botuese "8 Nëntori", Tiranë 1981.
- Papajani, Lazar: "Kalaja e Prezës", Revista Monumentet, 1974, nr. 7-8.
- Selenica, Teki: Shqipëria më 1923, Shtypshkronja "Tirana", Tiranë 1923.
- Selenica, Teki: Shqipëria më 1927, Shtypshkronja "Tirana", Tiranë 1928.
- Prof. Zyhdi Dervishi (http://www.trepca.net/2004/03/040313_zd_preza_qyteti_feniks.htm)

Kjo zonë shtrihet në veri-perëndim të Tiranës dhe njihej si “ Qyteza e Parthinëve (1508-1510) dhe jo pa arsye u lihet atyre zanafilla e themelimit të Prezës. Parthinët janë një fis i ilirëve në Shqipërinë e Mesme nga më luftarakët për mbrojtjen e vendit të tyre, por paqësorë mes njëritjetrit. Tani banorët duke ia ndryshuar emrin e quajnë Prezë (Marin Barleti) por bazuar mbi disa gojëdhëna emri “Prezë = Pres” mund të ketë ardhur nga një përlëshje mes fiseve ku u vranë e u prenë shumë njerëz.

Mendohet se Preza ka qenë qytezë sepse:

1- në Shekullin e XIX në Shqipëri ka pasur qytete pa kullë sahati, por nuk ka patur fshatra me kullë sahati.

2- në të gjitha shkrimet e ndryshme të autorëve më të shquar, vendas dhe të huaj që nga mesi i Shekullit të XV deri në fillim të viteve ‘30 të shekullit XX, Preza-Qendër karakterizohet si qytet ose qytezë.

Përpara luftërave civile të Çezarit dhe Pompeit (vitet ‘49-’45 p.e.r), kjo qytezë zinte një vend mjaft të nderuar në krahinë. Vetë gërmadhat e saj dhe vetë gjurmët e sendeve të veçanta lejojnë të shikosh dhe vlejën të parapërfytyrosh qartë shkëlqimin e gjendjes së dikurshme dhe bujarinë e lashtë të vendit. Thonë se e pushtoi dhe e shkatërroi Çezari, kur mbante të rrethuar qytetin e Durrësit, Pompein dhe senatin romak dhe mbeti përgjithmonë e sheshuar në atë gjendje gërmadhe dhe as u dukën më pas ndonjëherë gjurmë rindërtimi, përveç atyre që zelli i banorëve i ripërtëriu për nevojat e veta të ndryshme (326-327).

Në fillim të shekullit të XX një nga njohësit më të shquar të konstruksionit shpirtëror të popullit shqiptar, të kulturës shqiptare, Shtjefën Gjeçovi ka shkruar novelën që plotëson edhe parametrat e romanit të titulluar “Mnera e Prezës”. Në këtë vepër ai asnjëherë nuk flet për fshatin Prezë, por për qytetin e Prezës. Madje jo për një qytet të çfarëdoshëm, por për një qytet që realizonte dhe synonte nivele të larta emancipimi të vajzave dhe të grave shqiptare.

Në botimin jubilar “10 vjet Mbretni, 1928-1938” për Prezën, ndër të tjera, theksohet: “E ringjalluar prej Qeverisë Mbretërore si qendër turistike, Preza po merr një zhvillim të posaçëm nga lëvizja e turistëve të huaj që vijnë për të soditur vjetërsinë e këtij qyteti historik”. Mjaft fakte provojnë se në rrjedhën e shumë shekujve Preza ka ushtruar një funksion ndikues e emancipues për fshatarët që banonin në të gjithë krahinën e më gjerë. Fshatarët për shumë kohë e quanin Prezën shehër dhe banorët e Prezës shehërli, fjalë turke që përkthehet përkatësisht qytet dhe qytetarë.

Në rrafshin arsimor e kulturor Preza ka qenë gjithnjë më e përparuar se fshatrat që shtrihen rrotull saj. Sidomos gjatë shekullit XVI-XIX, ndërkohë që në shumë krahina të Shqipërisë nuk kishte asnjë formë të organizuar të shkollimit, në Prezë kanë funksionuar pothuajse gjithnjë shkolla të orientimit fetar. Shkolla e parë shqipe në Prezë u hap në vitin 1914. Modelimi psikologjik i banorëve të Prezës i plotësonte të gjitha parametrat për t’u karakterizuar si modelim urban.

Ndër të tjera, banorët dallohen për tolerancën, që shpërfaqet në të gjitha aspektet e veprimtarinë e mënyrës së tyre të jetesës, në marrëdhëniet ndërmjet grupimeve sociale dhe në marrëdhëniet ndër individuale ndërmjet banorëve me përkatësi subkulturore, fetare e politike të ndryshme. Tradicionalisht edhe në ditët tona ndër banorët e Prezës, jo vetëm nuk ka pasur konflikte për çështje fetare, por ata i frekuentojnë rregullisht pa kurrfarë paragjykimi fetar, vendet e shenjta myslimane e të krishtera, pavarësisht nga përkatësia e tyre fetare.

Në rrjedhën e trazuar të kohës shumica e objekteve arkitektonike të qytetit të Prezës janë shkatërruar ose janë zhdukur plotësisht. Kanë mbetur deri në ditët tona pothuajse vetëm kalaja dhe pusi.

☞ **Kalaja:** është monument kulture.

Kalaja ngrihet në pjesën më të lartë të vargut kodrinor të Prezës. Mjaft fakte provojnë se kalaja e Prezës ka shërbyer kryesisht si kullë kontrolli për rrugën me rëndësi ekonomike dhe ushtarake që lidhte Durrësin me Krujën dhe me Shkodrën. Gjithashtu kjo kala përbën edhe një pikë komunikimi vizual ose të përcjelljes së mesazheve nëpërmjet sinjaleve pamore, ndërmjet kalasë së Petrelës, të Krujës, të Durrësit dhe të Ishmit. Mendohet se kalaja është ndërtuar për herë të parë gjatë shekullit të tretë pas Krishtit. Që nga kjo kohë e deri në fund të shekullit të XIX është rrënuar dhe rindërtuar pothuajse krejtësisht disa herë. Mendohet që kalaja të jetë ndërtuar më herët, ku disa studiues arsyetojnë së paku që nga shekulli i II, para Krishtit. Më pas Preza ka qenë arenë ku janë zhvilluar beteja ndërmjet ushtrive më të fuqishme në rajonin e Ballkanit dhe më gjerë.

Flitet edhe për betejat e zhvilluara nga ushtria romake. Albanologu i shquar gjerman Johan George Von Hohn citon: përsa u takon fosilizimeve të gjetura në vargun kodrinor të Prezës që ndodhet në drejtimin perëndimor përballë Krujës, mund të cilësohet si një minierë e vërtetë. Kalaja ngrihet mbi 255 m mbi nivelin e detit. Hyrja e kalasë ka një strukturë prej guri në formë harku e cila është karakteristikë e ndërtimeve të lashta, po ashtu dhe rrugicat brenda kalasë janë të shtruara me kalldrëm. Kalaja të ofron pamje panoramike nga të gjitha anët ku vrojtohet qyteti i Tiranës, aeroporti i Rinasit, deti Adriatik në Durrës, Lezhë dhe Krujë. Ka 270 m linear murr rrethues. Brenda saj ndodhet xhamia dhe depozita e ujit e cila përdoret edhe sot për furnizimin me ujë të fshatit, por në kohën e pushtimit turk është përdorur si burg.

– **Kulla e sahatit** mendohet të jetë ngritur mbi kullën rrethore lindore gjatë gjysmës së parë të shekullit të XIX. Në vitin 1853 albanologu gjerman Johan George Von Hahn ka vizituar Prezën dhe ndër të tjera, ai përshkruan edhe kullën e sahatit dhe sahatin që funksiononte. Sipas dëshmimeve gojore të banorëve të Prezës deri në fillim të luftës së parë botërore çanga e këtij sahati dëgjohej në të gjitha fshatrat përreth Prezës deri në afërsi të Tiranës dhe Krujës. Kulla është pika më e lartë e vrojtimit në kala e cila ekziston dhe sot por pa sahat. Sahati u grabit nga austriakët dhe sot e kësaj dite ndodhet në një muze të Vjenës.

☞ **Pusi:** Përveç kalasë edhe pusi është shpallur monument kulture. Uji i pusit nuk pihet sepse sipas gojëdhënave të banorëve aty është mbytur një vajzë për të mos rënë e gjallë në dorë të turqve. Deri në vitet 1960 uji i pusit ka qenë i përdorueshëm por jo për të pirë.

☞ **Xhamia:** Para vitit 1967 ka qenë dykatëshe ku kati i dytë ka qenë prej dërrase. Thuhet që në kohët përpara pushtimit osman ka qenë kishë. Xhamia ka patur edhe minarenë e cila u prish më 1967. Minareja ishte e ndërtuar me kube prej guri shumë të mëdha dhe të lehta.

☞ **Teqet:** Ato janë të parregulluara siç kanë mbetur nga regjimi.

☞ **Pazari** Vite më përpara zhvillohej një ditë në javë pazari por për Prezën dhe të gjithë fshatrat përreth ku banorët tregtonin prodhimet e tyre bujqësore, punimet e tyre artizanale, vajin e ullirit, mjaltin, bagëtitë. Edhe sot e kësaj dite banorët e Prezës sheshin përpara kalasë e quajnë “pazar”.

☞ **Folklori:** Një ndër këngët e ruajtura është “Gocë prezjane”. Këngët e tjera këndohen nëpër dasma, të cilat edhe në ditët e sotme kanë shumë elementë tradicionalë. Dasmat fillojnë të premtën dhe aty iu këndohet të zotëve të shtëpisë, motrave (hallave dhe kunatave) vëllezërve (dajallarëve dhe xhaxhallarëve), dhëndrit, nuses. Të dielën e dasmës ka këngë të veçanta për dhëndrin, nusen, vjehrrin, vjehrrën, kunatat, ku përshkruhen marrëdhëniet ndërmjet nuses dhe vjehrrës, vjehrrit, zilitë ndërmjet kunatave. Dasmat sjellin edhe elementë të tjerë tradicionalë si: veshjet e kostumeve popullore jo vetëm nga

të mëdhenjtë por edhe fëmijët, për nusen që e presin tek dera me bukë dhe sheqer, thyerja e vezës nga nusja; përpara se të ngjitet në makinë, nusja rrëzon me këmbë një vazo me ujë. Krijimi më i fundit për kalanë e Prezës u këndua në evenimentin e zhvilluar në kala “Miss Shqipëria 2008”

☞ **Veglat muzikore**

1. Fyelli me pesë vrima
2. Pipza
3. Gjethi
4. Çiftelia

Për çiftelinë e Shqipërisë së mesme ka diskutime nëse është traditë e zonës apo e huazuar nga veriu. Instrumentisti nga Preza, Veli Çaka ka marrë çmime në festivalin folklorik të Gjirokastrës.

☞ **Kostumet**

Janë dy llojesh:

1. Kostumet e përditshme.
2. Kostumet popullore.

1. **Kostumet e përditshme** qepeshin nga banorët e zonës. Më përpara gratë e moshave më të reja përdornin dymiq prej cope ose atllazi me ngjyra të ndryshme, ndërsa moshat e vjetra dymiq të zinj. Në veshjet me dymiq ndikoi shumë pushtimi osman. Ndërsa burrat e moshave të vjetra vishnin brekushe të bardha. Më pas brekushet filluan t'i vishnin të zeza. Në kokë vendosnin qeleshe të bardha. Në ditët e sotme gratë në moshë të thyer vishen me pantallona dhe fustane të zeza, dhe shamitë të bardha që quhen lëvere ose napë.

2. **Kostumet popullore:** tek gratë kostumet përbëheshin nga dymiq, jelek, mungore. Dymiqët ishin prej ngjyre mermeri, ishin fijet me të cilat ishin qëndisur jelekët ose prej kremi. Jelekët qëndiseshin me fije ari ose gjyrmishi, ndërsa mungorja ishte bluza poshtë jelekut. Kostumet popullore te burrat përbëheshin prej: xhamadani, xhok, brekushe. Xhoka vishej nga njerëzit e pasur. Shumë veshje simpatizoheshin edhe nga shtresat e pasura për shembull “Kostumet e martesës”. Një shkrimtar anglez Jakob Haus dëshmon se kësulata e shqiptarëve silleshin nga qytetet e Italisë si Trieste, Livorno dhe Genova. Gjyrmishi është fije ari ose argjendi që shërbente për zbukurimin e kostumeve popullore dhe vinte nga Napoli. Kostumet e përditshme dhe ato popullore qepeshin dhe qëndiseshin nga gratë e Prezës dhe shiteshin në pazarin e grave. Përveç kostumeve në pazarin e grave shiteshin edhe punimet me vegjë. Në 10-vjeçarët e fundit të shekullit të XIX u fut makina qepëse dhe veshjet filluan të ndrëshonin. Kostumet popullore sot ruhen si relike, por edhe vishen nëpër dasma.

☞ **Punimet artizanale:** Ndryshe në Prezë njihen edhe si punët me vegjë. Mund të përmendim përparëse ose boksh, çarçafë, mbulesa tavoline, shami, peceta, qilima, hasër. Të gjitha këto janë të trashëguara brez pas brezi. Përveç punëve me vegjë janë edhe qëndisjet, punët me grep, punët me shtiza. Kohët e fundit qëndisjet me makinë qepëse.

☞ **Zejtaria:** U zhvillua shumë në shekullin e 18 ku punoheshin sofa, vegjë dhe vegla muzikore. Thikat, tehet e shpatave, tytat e pushkëve importoheshin nga Venediku.

☞ **Nallanet:** Nallanet (pandoflat) ishin prej druri dhe pjesa lart me llastikë. I vishnin gratë dhe vajzat.

- ☞ **Mullinjtë e vajit:** Përdoreshin nga banorët e Prezës për prodhimin e vajit të ullirit. Por një pjesë e banorëve vajin e prodhonin duke e shtypur me këmbë një thes të mbushur me ullinj dhe i hidhnin ujë të ngrohtë.
- ☞ **Mullinjtë me ujë:** Kanë ekzistuar deri më 1960 dhe shërbenin për bluarjen e drithërave, tani nuk ekzistojnë më.
- ☞ **Mokra e dorës:** Përdorej për thërrmimin e misrit ose siç njihet ndryshe bollguri.
- ☞ **Dybeku:** Shërbente për shtypjen e grurit. Është një gur i thellë. Gjendet akoma nëpër disa shtëpi në Prezë dhe përdoret akoma.
- ☞ **Arkitektura e punimit të banesave të vjetra:** Dritaret ishin të tipit frëngji, ku të katra anët e shtëpisë bëheshin me dritare të vogla me harqe dhe kapakë prej druri.
- ☞ **Ullishta:** Një vlerë tjetër historike janë dhe ullinjtë që mbulojnë të gjithë kodrën, ku shumica prej tyre janë shekullorë. Sipas gojëdhënave ku martohej një çift i ri, duhej të mbillte 20 rrënjë ullinj.

Analizë e vlerave

- ☞ **Kalaja:** Në kala muret nuk janë në gjëndje të mirë edhe pse kohët e fundit i është bërë një restaurim. Në kala ka qënë vendosur antena e AMC gjë që i prishte pamjen e saj. Kohët e fundit me insistimin e pushtetit vendor është hequr antena e AMC gjë që po e sjell në identitet kalanë. Në kala akoma ekziston depozita e ujit e cila shërben për ujësjellësin e Prezës. Duhet një ndërhyrje urgjente në rregullimin e mureve. Duhet rregulluar kalldrëmi në hyrje të kalasë përgjatë rrugës rreth kalasë duhet të vendosen tabela të cilat japin informacion të qartë mbi arkitekturën dhe historinë. Grupi ynë mendoi se studimi me kriter shkencor i para historisë së Prezës, restaurimi i monumenteve të saj veçanërisht i kalasë përfaqësojnë një kontribut të rëndësishëm për të plotësuar “hapësirën” e atlasit kulturor, që ka rëndësi jo vetëm për Prezën e kulturën kombëtare Shqiptare, por edhe për historinë e kulturën e vendeve fqinje me Shqipërinë, me të cilat në rrjedhën e historisë shkëmbimet ekonomike, kulturore dhe përplasjet ushtarake kanë qënë më të shpeshta e më ndikuese. Meqenëse impakti social dhe ekonomik janë positive, grupi ynë mendoi që kalaja duhet të përdoret për aktivitete kulturore, si dhe festivale stinore që mund të përkujtojnë edhe aktivitete historike.
- ☞ **Kulla e sahatit:** Për të rikthyer shkëlqimin e dikurshëm grupi mendoi të imitohet një sahat me origjinalin që ndodhet në Austri dhe të vendoset. Kulla të qëndrojnë gjithmonë e hapur për vizitorët meqenëse është edhe pika më e lartë e vrojtimit në kala. Gjithashtu dimë që muzeut të Vjenës i është bërë kërkesë për kthimin e sahatit. Meqenëse as kalaja dhe as pusi nuk janë nën administrimin e pushtetit vendor, të tre grupet menduam për kërkesat që pushteti vendor të bëjë për ta administruar kalanë. Meqenëse komuna e kishte nisur më përpara këtë gjë, në grupet e punës u mendua si plan afatgjatë. Edhe pse kalaja nuk është nën administrimin e pushtetit vendor ai ka vendosur të bëjë ndriçimin e kalasë.
- ☞ **Xhamia:** Meqenëse xhamia nuk është nën administrimin e pushtetit vendor, grupi mendoi se një sugjerim do të ishte i volitshëm: Të gjenden donatorë që të bëhet rindërtimi i minaresë së xhamisë në vendin që ka qënë më përpara si edhe rregullimi i teqeve.
- ☞ **Pazari:** Meqenëse ndikimi në jetën shoqërore dhe ekonomike të banorëve të Prezës ka qënë pozitiv, grupi mendoi se në standardet që dëshirojmë për pazarin është që ai të marrë shkëlqimin e mëparshëm, ku fillimisht mund të bëhen panairë me prodhimet bio dhe punimet artizanale.

- ☞ **Folklori:** Ka pasur një ndikim të madh në jetën shoqërore edhe pse nuk ka qenë fitimprurës. Edhe pse këngët tradicionale këndohen akoma nëpër dasma, ato akoma nuk janë mbledhur nga specialistë. Jo vetëm këngët e zonës por edhe fjalët e dialektit të zonës së Prezës, dhe poezitë e vjetra duhen mbledhur e arkivuar.
- ☞ **Veglat muzikore:** Për sa u përket veglave muzikore ato nuk punohen më nga banorët e Prezës. Ka instrumentistë që luajnë me vegla muzikore nga dëshira dhe kënaqësia që iu jep atyre. Shumica i kanë mësuar vetë por pa ndjekur një shkollë të veçantë. Përveçse nga kënaqësia një pjesë e instrumentistëve e kanë gjetur edhe si burim i të ardhurave ekonomike, sepse marrin pjesë në festa familjare dhe dasma të ndryshme. Instrumentistë të mirëfilltë gjen shumë pak në Prezë, prandaj dhe për këtë vlerë duhet një ndërhyrje emergjente për të gjetur talente të reja, pse jo në shkollë.
- ☞ **Kostumet:** Siç u tha dhe më përpara, kostumet tradicionale dhe popullore kanë qenë përdorur shumë nga banorët dhe vitet e fundit as nuk vishen më, ose janë modifikuar. Standardi që dëshirojmë është që kostumet të ruhen sipas traditës dhe të mos ndryshojnë. Meqenëse palë të interesuara janë përdoruesit dhe prodhuesit, shikohet se kostumet popullore dhe tradicionale janë drejt zhdukjes, prandaj duhet një ndërhyrje emergjente duke organizuar panaire të ndryshme pse jo edhe kurse për qepjen e tyre.
- ☞ **Punimet artizanale:** Kanë pasur dhe kanë ndikim pozitiv në jetën ekonomike të banorëve, pasi këto punime kërkojnë shumë, jo vetëm nga banorët por edhe nga emigrantët që përveçse për përdorim vetjak u bëjnë dhurata të huajve. Aq të kërkuara janë këto punime me vegjë, qëndisjet e punimet me grep, saqë mund të themi se nuk mungojnë në asnjë pajë të vajzave që martohen. Në qoftë se flasim për rrisqet e kësaj vlere duhet një ndërhyrje emergjente:
- Duke stimuluar trashëgiminë.
 - Duke hapur kurse për brezat e rinj sepse punuesit ose artizanët janë drejt zhdukjes.
- ☞ **Mullinjte e vajit të ullirit:** Përsa i përket nivelit të rrezikshmërisë shikohen si konkurrenca fabrikat e vajit, prandaj duhet një ndërhyrje në shtimin e ullinjve, pasi kështu do të shtohen edhe mullinjte e vajit të ullirit.
- Perveçse kanë ndikim pozitiv në nivelin ekonomik ato shfaqin edhe problemet mjedisore sepse murgja (precipitati i vajit) ndot tokën dhe ujërat. Nga ky problem preken banorët e Prezës dhe vizitorët. Kjo ndotje vjen nga:
1. mos respektimi i masave.
 2. grumbullimi i mbeturinave të mullinjve vend e pavend.
- ☞ **Ullishta:** Edhe pse shikohet një kujdesje e madhe e pronarëve për ullinjte, ata nuk marrin iniciativën për mbjelljen e ullinjve të rinj dhe shtimin e tyre.
- ☞ **Gazeta Preza:** Ka qenë një tjetër vlerë e cila për arsye ekonomike nuk botohet më kohët e fundit. Zgjidhja e këtij problemi është që të gjenden financues të ndryshëm për ribotimin e gazetës.
- ☞ **Preza television:** I cili që të fuqizohet më tepër ka nevojë për financime të ndryshme.

↳ **Teleferiku:** I ndërtuar nga Austriakët që të ngjithnin mallrat nga fusha në kodrën e Prezës për të shmangur lartësinë.

3 - Vlerat kryesore të komunës (Grupi i Pyjeve dhe Biodiversitetit)




Grupi i pyjeve dhe biodiversitetit ka punuar intensivisht dhe përgjatë këtij viti ka ndërmarrë një sërë aktiviteteve si takimet e grupit të punës, programet televizive, posta dhe letra nga komuniteti, fletëpalosjet, punë në terren, foto dhe grumbullim informacioni. Në një nga takimet e radhës së grupit u listuan vlerat ekologjike të zonës Prezë si dhe elementët brenda secilës vlerë. Brenda Komunës ekziston Zyra e bujqësisë dhe shërbimeve e cila merret, ndër të tjera, me masat mbrojtëse fizike të tokës, pyjeve, kullotave, ruajtjen e kafshëve, shpendëve, me sëmundjet zoornike etj.

Grupi i pyjeve dhe biodiversitetit me anë të këtij dokumenti ju paraqet rezultatet e punës një vjeçare të personave të angazhuar, drejtimet kryesore që ky grup do të dëshironte të ndërmerre si dhe aktivitete konkrete që do të ndërmerren nga pushteti vendor së bashku me komunitetin. Parë në kontekstin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe zhvillimin e komunës si një vend me potenciale bio, grupi i pyjeve dhe biodiversitetit ka vecuar vlera të tilla si:

- florën dhe faunën,
- pyjet e veçanërisht ullishtat që janë karakteristike për zonën dhe shërbejnë edhe si burim të ardhurash për banorët;
- liqenet;
- lumi;
- burimet nëntokësore si dhe
- produktet bio, një term ky që për Prezanët është i zakonshëm, por që vlerësohet shumë nga turistët si vendas, ashtu edhe të huaj.

Të gjitha këto vlera së bashku me vlerat kulturore dhe arsimore të zonës përbëjnë potenciale të vërteta për zhvillimin e qëndrueshëm të zonës dhe promovimin e saj si zonë ekologjike.

Elementët brenda vlerës



Peshkim/ Gjueti

Palët e interesuara

Interesimi për vlerat e sipër përmendura është një nga pikat më kryesore që shoqëria e vlerëson, për atë që ka qenë dikur dhe për atë që është sot. Banorët e Prezës, turistët, pushteti vendor, bizneset ,etj janë të interesuar për këto vlera të rëndësishme.

Këto vlera janë të rëndësishme për banorët e Prezës sepse resurset e tyre mund të shfrytëzohen në shumë drejtime. P.sh. Pyjet sjellin fitime duke ditur se kërkesat për lëndën drusore janë të larta. Nga ana tjetër ato janë mushkëria e gjithë zonës dhe shërbejnë si burime atraktive jo vetëm për vizitorët, por edhe për vetë banorët e zonës. Burimet natyrore janë të pasura dhe si pasojë krijohen kushte për aktivitete si gjueti, piknik etj. Gjithashtu edhe vlerat e tjera influencojnë në jetën sociale dhe ekonomike të zonës.

Aktualisht ruajtja e Biodiversitetit është e dorës së dytë për pushtetin vendor dhe akoma më keq për vetë banorët, prandaj ajo kërkon akoma shumë për të bërë. Në këndvështrimin tonë strategjia me optimale është ruajtja dhe mbrojtja e speciest, ruajtja dhe mbrojtja e habitateve si dhe mirëmenaxhimi i tyre.

Grupi i Infrastrukturës Turistike

Tendencat, ndikimet dhe standardet

Për secilin element brenda vlerës u panë ndikimet në jetën social - ekonomike dhe u vlerësuan sipas ndikimeve me simbolet pozitive, negative dhe 0 për asnjë ndikim.

Tendencat dhe ndikimi në jetën social-ekonomike						
Elementi/ vlera	Para 90-tës +	Para 90-tës 0	Para 90-s -	Pas 90-tës +	Pas 90-tës 0	Pas 90-tës -
Zyrë informacioni		Nuk ekzistonte			Nuk ekziston	
Muze	Ekzistonte					U prish
Agjensi turistike		Nuk ekzistonte			Nuk ekziston	
Guidë turistike		Nuk ekzistonte			Nuk ekziston	
Tabela informacioni		Nuk ekzistonte		2 Tabela mirëse-ardhjeje që i nxisin vizitorët		
Akomodim	Turizëm veror familjar 1-2 javë					
Argëtim	Sporte të organizuara gjueti, peshkim				Spontane, organizim grupesh të vogla	
Siguri/shëndetësi	24 orë me staf të kompletuar					12 orë staf i reduktuar
Aksesibiliteti	Rrugë e mire/telefon			Ka vizitorë		Rrugët duan ndërhyrje
Autenticiteti	Ushqim tradicional			Shtim klientele në restorante		

Standardet

Duke pasur parasysh se turizëm pa standarde nuk ka, u analizuan standardet ekzistuese dhe u mor opinioni i komunitetit se çfarë standardesh do të dëshironte ai për infrastrukturën turistike. Me të dhënat u hartua tabela më poshtë:

Standardet				
Elementi	Aktuale		Të dëshiruara	
	Cilësor	Sasior	Cilësor	Sasior
Uji i pijshëm	Nuk ka			150 L/person
Rrugët	Nuk ka		Asfalt	
Shëndetësia	Nuk ka		Urgjencë 24 orë	
Hoteleria	Nuk ka		Me *****	
Telefoni fikse	Nuk ka			Të paktën 3 kabina
Ndërtimet	Nuk ka		Në përshtatje me kalane. Stil tradicional.	
KUZ (Kanalizimi i ujrave te zeza)	Nuk ka	Aktualisht 2 fshatra		Në 7 fshatrat
Mbetje urbane	Nuk ka		Reduktimi/ riciklimi	
Guida turistike	Nuk ka			2 persona me 3 gjuhë të huaja

Për Grupin e Infrastrukturës Turistike, tipet e rrisqeve në elemente të ndryshme brenda kësaj vlere janë:

Ka konflikt kompetencash për të hapur dhe mirëmbajtur një zyrë/ qëndër për informacion Turistik

Ka një konkurrencë shumë të madhe nga agjencitë e tjera turistike në rajon, veçanërisht ato të Krujës, Durrësit dhe Tiranës, të cilat marrin vizitorë vetëm në qytetet e tyre.

Objektet nuk janë në gjëndje të përshtatshme për momentin për t'u vizituar nga turistët. Duke mos u përkujdesur për to, ato do të degradohen akoma më shumë. Nuk ka tabela informuese, që turistët të marrin disa njohuri. Nëse vazhdojnë kështu, ato do të harrohen.

Mungesa e fondeve për të hapur dhe mirëmbajtur një muze në Prezë.

Kosto shumë të larta për të ndërtuar një hotel në Prezë, duke marrë parasysh gjëndjen e tanishme të numrit të turistëve të cilët kanë dëshirë të kalojnë një natë në Prezë.

Tendencat e argëtimit janë të tilla, që shumica e njerëzve preferojnë të shpenzojnë kohën dhe paratë e tyre në bar-kafe dhe restorante dhe jo në natyrë duke bërë aktivitete argëtuese.

Globalizimi në mënyrën e jetesës dhe mënyra se si njerëzit vishen dhe ushqehen, paraqet një rrezik në humbjen e veshjeve autentike, ushqimit dhe mënyrën e jetesës tradicionale.

Rreziqet dhe mundësitë			
Elementi vlera	Shkalla e rrezikut	Lloji	Më emergjente 5 Më pak emergjente 1 Nuk ka -
Zyrë informacioni	E lartë (vazhdimësia në inekzistente)	Mungesë personeli, ambienti, përplasje kompetencash	1
Muze	E lartë (vazhdimësia në inekzistente)	Mungesë fondesh	5
Agjensi turistike	E lartë (vazhdimësia në inekzistente)	Konkurrencë e lartë Kruja, Objekte jo të gatshme për vizitorë	1
Guidë turistike	E lartë (vazhdimësia në inekzistente)	Objekte jo të gatshme për vizitorë	1
Tabela informacioni	E ulët (ka por të pamjaftueshme)	Informacion tërheqës jo i mjaftueshëm në lloj dhe sasi	1
Akomodim	E mesme (në varësi të kërkesës)	Kosto e lartë për ndërtim hotelerie	3
Argëtim	E mesme (pamjaftueshmëri)	Tërheqje drejt kalimit të kohës nëpër lokale	3
Siguri/shëndetësi	E mesme (pamjaftueshmëri)	Mungesë urgjence 24 orë, mungesë stafi	5
Aksesibiliteti	E ulët (pamjaftueshmëri numër dhe cilësi)	Amortizime	5
Autenticiteti	E ulët (nuk publikohen të vecantat e zones)	Globalizmi stil i ri jetese	2
Ujë i pijshëm	E lartë (pamjaftueshmëri në sasi)	Amortizime të theksuara	5

Problemet dhe shkaqet

Përgjatë punës në grupe, grupi i Infrastrukturës turistike nxori këto probleme dhe shkaqe kryesore :

1. Atraktiviteti për turistët { nga ana historike, kulturore, pejsazhi, }*Problemet mjedisore:*

- Rrëshqitjet dhe shkarjet e dheut, kanë shkaktuar plasaritje të murit të kalasë dhe shembje të kullës së kalasë.
- Zjarret në pyje
- Ndërtimet pa kriter
- Ndërtimet jo tradicionale
- Mbeturinat

Shkaqet:

- Për rrëshqitjet e dheut dhe zjarret në pyje janë kryesisht natyrore, por nuk do të përjashtonim dhe rastin e vënies së zjarreve nga njerëzit.
- Zbatueshmëria e dobët e ligjit të urbanistikës
- Mospasja e statusit “ Fshat turistik”
- Edukimi i komunitetit i ulët

2. Turizmi familjar*Problemet mjedisore:*

- Mbeturinat
- Uji i pijshëm dhe kanalizimet

Shkaqet:

- Edukimi i komunitetit i ulët dhe mungesë Infrastrukture dhe planesh të menaxhimit të mbeturinave.
- Mungesë investimesh nga Pushteti Qëndror
- Mungesë fondesh nga niveli lokal
- Korrupsioni në zbatimin e fondeve të dhëna

3. Argëtimi në natyrë

Problemet mjedisore: Aksesibiliteti, jo rrugë të përshtatshme për zhvillimin e turizmit

Shkaqet: S’ka fonde dhe planifikim

U bë edhe një analizë e detajuar e aktorëve përgjegjës, tendencave aktuale dhe mundësisë për ndërhyrje urgjente, siç jepet në tabelën më poshtë:

Problemet dhe shkaqet			
Grupet që preken	Aktorët përgjegjës	Ndërhyrja urgjente	Tendencat aktuale
Biznesi në industrinë e turizmit	Qeveria qendrore nuk delegon në praktikë kompetencat Q.V. (Qeveria vendore)	<ul style="list-style-type: none"> ○ Uji i pijshëm dhe kanalizimet ○ Aksesibiliteti ○ Mbeturinat 	<ul style="list-style-type: none"> ○ I përditshëm me orar, kanalizimet për fshatrat e tjerë ○ Të amortizuara; ○ Hidhen kudo dhe ska venddepozitë
Komuniteti në Prezë	Pushteti vendor: përgjegjës për mungesën e investimeve në	<ul style="list-style-type: none"> ○ Ndërtime pa leje, pa stil tradicional; ○ Rrëshqitjet e dheut 	<ul style="list-style-type: none"> ○ Deri 2007 ndërtime pa leje, tani zyre urbanistike në

	alternativë për ujin e pijshëm		komunë; o Nuk respektohet stili tradicional
Familje që praktikojnë turizmin familjar	Një pjesë e komunitetit që dëmtojnë rrjetin e ujit të pijshëm, ndotin ambientin, presin pyjet etj	o Zjarret ne pyje	o Spontane dhe të paparashikuara; o Sporadike gjatë verës
Turistët vendas	Pronarët e lokaleve e restoranteve. Komuna. Agjencitë turistike.	Reklamim sa më i madh i Prezës dhe vlerave të saj.	o Ka vizitorë jo të rregullt, kryesisht nga Tirana e qytetet fqinje, që vijnë sipas dëshirës e të paorganizuar për restorantin në kala.

Zgjidhjet e propozuara

Për problemet mjedisore të identifikuar nga grupi i punës u ofruan këto zgjidhje:

1) Rrëshqitjet e dherave

Të adresohet ky problem në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, po ashtu edhe në Institutin e Monumenteve, nën juridiksionin e të cilit është Kalaja.

Të lobohet për të forcuar muret e kalasë dhe të mbillen më shumë pemë në kodrën në të cilën është ndërtuar kalaja. Vendosja e disa rrufepritëseve për të parandaluar goditjen e mureve të kalasë.

2) Zjarret në pyje

Ky problem është zgjidhur tashmë. Janë disa punëtorë që shuajnë zjarret, dhe komuna vetë bashkëpunon shumë mirë për shuarjen e zjarreve në verë. Rrufepritëset duhet të vendosen në pikën më të lartë të kodrës që të mbrojnë dhe pyjet gjithashtu.

3) Ndërtimet pa kriter dhe jo me stil tradicional

